



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Lënda: Mbi trajtimin e kërkesës për informacion.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Tiranë

EMISIONIT INVESTIGATIV “VETTING”, NEWS24

Tiranë

Në vijim të kërkesës për informim të emisionit investigativ “Vetting” me nr. 2403/082 prot., datë 08.03.2024, protokolluar me tonën nr. 1554 datë 13.03.2024, nëpërmjet së cilës, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, kërkohet informacion në lidhje me emërimet dhe transferimet në disa poste publike që mbahen nga nëpunës civilë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT), për periudhën Janar 2021 e deri më sot, ju bëjmë me dije se:

Kërkesa (I) dhe (II)

Lidhur me informacionin e kërkuar për emërimet në disa poste publike që mbahen nga nëpunës civilë dhe lidhur me transferimet e nëpunësve në këto pozicione, për periudhën nga Janar 2021 e deri më sot është njësia e burimeve njerëzore pranë DPT-së ajo që administron të dhënat e plota në lidhje me këto pozicione, si dhe vakancat e krijuara përgjatë kësaj periudhe.

Për këto arsye, Departamenti i Administratës Publike (DAP) me shkresën nr. 1554/1 prot., datë 20.03.2024 ka kërkuar që të shqyrtohen dhe verifikohen dosjet e personelit të punonjësve pranë DPT-së, në lidhje me të dhënat e kërkuara. Kjo referuar pikës 1, të kreut I, të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2022 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, ku përcaktohet se: “*Institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të krijojnë e të administrojnë dosjen e personelit të çdo të punësuarit në institucionin e tyre.*”. Për sa më sipër, është DPT institucioni që mund të përcjellë informacionin e kërkuar.

Kërkesa (III)

Lidhur me informacionin e kërkuar për disa nëpunës konkret, DAP, në zbatim të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, i ka kërkuar DPT-së të marrë dakordësinë e punonjësve për të cilët kërkohet informacion. Me shkresën nr. 5218 prot., datë 25.03.2024, protokolluar me tonën nr. 1554/2 datë 28.03.2024, DPT është përgjigjur se punonjësit e përmendur në kërkesën për informim nuk kanë dhënë pëlqimin për shkëmbimin, publikimin apo përpunimin e të dhënave të tyre, për qëllime të ndryshme nga ato që janë mbledhur, sipas nenit 6 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Në vijim, DAP iu drejtua Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Zyra e Komisionerit) me shkresën nr. 1554/3 prot, datë 29.03.2024, për të vlerësuar nëse informacioni me lidhje me emërimet dhe transferimet në disa poste publike që mbahen nga nëpunës civilë pranë DPT-së, mund t'i vihen në dispozicion palëve të treta.

Me shkresën nr. 891/1 prot, datë 09.04.2024 Zyra e Komisionerit, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“...vlerësimi përfundimtar i takon institucioneve respektive, në cilësinë e kontrolluesve të të dhënave, pasi janë këto të fundit që përcaktojnë qëllimet, mënyrat e përpunimit, (publikimit/përhapjes) të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, si dhe specifikat e natyrës së tyre të punës.”*

Në nenin 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, ndër të tjera, përcaktohet se:

“1. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

a) të drejtën për një jetë private;

b) sekretin tregtar;

c) të drejtën e autorit;

ç) patentat...

2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;

b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;

c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;

ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;

d) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;

dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;

e) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;

ë) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërko-mbëtare ose ndërqeveritare...”

Për sa më sipër, DAP nuk mund të përcjellë të dhënat e kërkuara përsa kohë që DPT me shkresën nr. 5218 prot., datë 25.03.2024, të cilën e gjeni bashkëlidhur, është shprehur se punonjësit nuk kanë dhënë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATES PUBLIKE
